



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501542/5

Tiranë ___/___/2015

Lënda: *Kërkesë për fillimin e ecurisë disiplinore dhe marrjen e masës disiplinore ndaj Shefit të Komisarariatit të Policisë Krujë, Mojsi Sulaj.*

Drejtuar : Drejtorisë së Policisë së Shtetit
Drejtorisë së Standardeve Profesionale
Z. Dylaver SHIMA

Tiranë

Për dijeni : Drejtorit të Policisë së Qarkut
Z. Perlat ÇULLAJ

Durrës

I nderuar zoti Shima,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë bërë ankesa shtetasit I.D., A.D. dhe B.Z.. Nëpërmjet ankesave të tyre ata pretendojnë se janë keqtrajtuar fizikisht nga punonjësit e policisë në Stacionin e Policisë Fushë Krujë gjatë shoqërimit dhe marrjes në pyetje. Respektivisht shtetasi I.D. në datën 08.08.2015, ndërsa shtetasit A.D. dhe B.Z. në datën 11.08.2015. Gjithashtu shtetasit A.D. dhe B.Z. pretendojnë se janë arrestuar padretësisht nga punonjësit e policisë.

Përveç personave të cituar më sipër, në Institucionin tonë ka bërë ankesë edhe shtetasi G.M.. Ai shkruan se, në datën 08.08.2015 është qëlluar me armë zjarri me dy plumba, një në kokë dhe tjetri në këmbë. Ankuesi pretendon se, policia nuk ka marrë asnjë masë për gjetjen dhe kapjen e autorëve të vrasjes së tij, të mbetur në tentativë dhe se ai ndihet i kërcënuar për jetën.

Për shqyrtimin dhe zgjidhjen e këtyre ankesave, bazuar në pikën 4, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: "*Organet dhe funksionarët publike janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij; në ligjin nr.*

8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe konkretisht, në nenin 19, gërma "b" ku parashikohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*"; si dhe në nenin 19, paragrafi i fundit, ku parashikohet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme*", me shkresat tona respektivisht nr. K2/I36-2 Prot., datë 09.09.2015; nr. K2/A60-2 Prot., datë 09.09.2015; nr. K2/B25-2 Prot., datë 09.09.2015 dhe nr. K2/G16-2 Prot., datë 09.09.2015, i kemi kërkuar Shefit të Komisarariatit të Policisë Krujë që të bëjë verifikimin e tyre dhe të na dërgojë shpjegime brenda afatit ligjor.

Ndonëse afati ligjor për kthimin e përgjigjeve të shkresave tona kaloi, ai nuk na i dërgoi ato. Për të bërë të mundur shqyrtimin e rasteve të ankuesve të cituar më sipër u detyruam që me shkresën nr. K2/I36-4 Prot., datë 28.10.2015 ta përsërisnim kërkesën tonë duke i kërkuar dërgimin e shpjegimeve brenda 5 ditëve nga data e mbërritjes së shkresës tonë.

Ndërkohë nëpërmjet kësaj shkrese i kujtuam atij se, detyrimi i organeve të administratës publike për të bashkëpunuar me institucionin e Avokatit të Popullit dhe për t'i kthyer përgjigje kërkesave të tij është parashikuar në Kushtetutë dhe në ligj. Gjithashtu i bëmë të ditur se ligji nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", në nenin 22/1 të tij parashikon edhe të drejtën e Avokatit të Popullit për të kërkuar masa disiplinore ndaj punonjësve të administratës publike të cilët nuk bashkëpunojnë me të.

Megjithatë, edhe pas kërkesës së dytë, ai përsëri nuk na i dërgoi përgjigjet e kërkuara nga ana jonë. Moskthimi i përgjigjeve të kërkuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit është një nga rastet tipike të mosbashkëpunimit të punonjësve të administratës publike me institucionin tonë.

Ky qëndrim i Shefit të Komisarariatit të Policisë Krujë me institucionin tonë ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve dhe në kthimin në kohë të përgjigjeve ankuesve. Ndërkohë kjo sjellje cënon rëndë marrëdhëniet tona institucionale, si dhe imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik.

Për këto arsye, bazuar në nenin 22/1 të ligjit "Për Avokatin e Popullit" ku parashikohet se: "*Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil*",

KËRKOJMË:

1. Fillimin e procedurës administrative (ecurisë disiplinore) dhe marrjen e masës disiplinore ndaj Shefit të Komisarariatit të Policisë Krujë, Mojsi Sulaj.

2. Ky rast të përgjithësohet dhe t'u bëhet i njohur gjithë drejtuesve organeve vendore të Policisë së Shtetit në vend me qëllim që sjellje të tilla të mos përsëritet më në të ardhmen.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj kësaj kërkesë dhe masën disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit "Për Avokatin e Popullit".

Bashkëlidhur po ju dërgojmë edhe fotokopje të shkresave tona dërguar Shefit të Komisarariatit të Policisë Krujë me nr. K2/I36-2 Prot., datë 09.09.2015; nr. K2/A60-2 Prot., datë 09.09.2015; nr. K2/B25-2 Prot., datë 09.09.2015; nr. K2/G16-2 Prot., datë 09.09.2015 dhe nr. K2/I36-4 Prot., datë 28.10.2015.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI